



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektori i UP:

Prof. Dr. Marjan Dema

Nr. Prot: 482

Datë: 23/2018

Mbështetur në nenin 25, paragrafi 1 dhe 2, nenin 28 të Statutit të Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në shqetësimet e parashtruara nga Këshilli Drejtues (KD) në kuadër të takimit të tij të mbajtur më 22.02.2018, bazuar në email-in e kryesues së KD (dërguar me datën 27.02.2018, në orën 15:50), si dhe bazuar në rekomandimet e dala nga takimi i mbajtur më 28.02.2018, marrë këtë

VENDIM

- I. Anulohet Konkursi me Ref. Nr. 263 datë 06.02.2018 i shpallur për vende të lira të punës në Administratën e UP, i publikuar me datën 06.02.2018.
- II. Obligohet menaxheri i personelit që të veprojë konform pikës I të këtij vendimi.

ARSYETIM

Këshilli Drejtues i UP, në mbledhjen e mbajtur më datën 22.02.2018, në kuadër të pikës së rendit të ditës "Të ndryshme", diskutoi në lidhje me Konkursin (Ref. Nr. 263, datë 06.02.2018) e publikuar për plotësimin e vendeve të lira të punës në administratën e UP, ku theks i veçantë iu vu kualifikimit dhe përvojës së punës së kërkuar për plotësimin këtyre vendeve të punës.

Për qëllime të Konkursit në fjalë, kryetarja e KD të UP, me datën 27.02.2018, nëpërmjet email-it, konfirmoi shqetësimet e saj për Konkursin e publikuar, sidomos sa i përket specifikave dhe standardeve për të cilat duhet të aplikohen në rast të plotësimit të vendeve të punës në institucione akademike siç është UP.

Rektori i UP, me qëllimin më të mirë në avancimin e kritereve dhe shmangies së çdo mundësie për krijimin e keqkuptimeve eventuale që mund të vijnë si rezultat i punësimeve në UP, më datën 28.02.2018, realizoi një takim të përbashkët me znj. Ardiana Bunjaku, kryesuese e KD të UP, Esat Kelmendi, sekretar i përgjithshëm i UP, dhe Fidan Hamiti, menaxher i personelit të UP.

Në këtë takim, ndër të tjera u diskutua mundësia e anulimit të Konkursit dhe rishpallja e tij në një afat sa më të shkurtër, si dhe u diskutua mundësia e plotësimit të tij me kushte dhe kritere më të avancuara sidomos për disa vende specifike të cilat kërkojnë ekspertizë relevante, propozim të cilën dha znj. Ardiana Bunjaku kryesuese e KD.

Rektori i UP, duke qenë i hapur në zbatimin e politikave të organit më të lartë qeverisës të UP, më qëllim të avancimit të kushteve dhe kritereve për plotësimin vendeve të punës në administratën e UP, mbështetur në atë që u tha më lartë, në konsultim me kryesuesen e KD, sekretarin e përgjithshëm të UP, dhe menaxherin e personelit të UP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP,
2. Menaxherit të personelit të UP,
3. Sekretarit të Përgjithshëm të UP,
4. Rektorit të UP,
5. Këshillit Drejtues të UP.



Rektori i UP

Prof. Dr. Marjan Dema